Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0791

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa HAsani-kryetarë, duke vendosur sipas ankesës së OE "Cami Kom" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Rrugës Pallaniku në Fshatin Berishë KK-Malishevë-Ritender" me numër të prokurimit 62500-23-9341-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Malishevës, më 06/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Cami Kom" SH.P.K. me nr. 2023/0791, e datës 13/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Rrugës Pallaniku në Fshatin Berishë KK-Malishevë - Ritender", me numër të prokurimit 62500-23-9341-5-2-1, të KK Malishevë dhe mbetët në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues "Cami Kom" SH.P.K i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.09.2023, Komuna e Malishevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Rrugës Pallaniku në Fshatin Berishë KK-Malishevë - Ritender" me numër të prokurimit 62500-23-9341-5-2-1.

Me 27.09.2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar OE "Agim Morina B.I."

OE "Cami Kom" SH.P.K me datë 02.10.2023 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datën 04.10.2023, AK me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Cami Kom", me datë 13.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0791, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjedhje të mosmarrëveshjes në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke u mbështetur në nenin 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP-së, Paneli Shqyrtues me datën 25.10.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr.791/23, ndërsa me datën 30.10.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0791 me rekomandimin si në vijim: "ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha paletë procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ankues nuk pajtohet.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Lidhur me pretendimet e OE "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve, ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr.2023/0791 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, ndërsa AK – Kuvendi Komunal Malisheve me datë 27.09.2023, ka njoftuar OE ankues "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve përmes Letra standarde si tenderues i pasuksesshëm. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore të OE ankues "Cami Kom", sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56, 59, 71 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 26 dhe 38 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "Agim Morina B.I"-Malishevë, nuk ka plotësuar kërkesat tek pika 9.1&9.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat 9.1&9.2 (2 dhe 3) Kapaciteti teknik dhe profesional: AK ka kërkuar: referoju dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Bazuar në shkresat e lëndës, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë lidhur me kërkesën nr. 2 ka dorëzuar me tender dokumentet si: Dokumentin me titull "7.Ing Gjeodezise.rar" dhe "10.marrveshja për Paisje gjeodezike.pdf". Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se inxhinieri në fjalë ka kualifikimin shkollor sipas kërkesës se AK-së, posedon licence valide, ka të bashkangjitur cv dhe referencat të cilat dëshmojnë përvojën e punës sipas kërkesë së AK. Për të njëjtin është bashkangjitur edhe Kontrata e punës për punë dhe detyra specifike për këtë projekt, kjo kontratë është e nënshkruar në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit, që plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se kontrata është nënshkruar me datën 12.09.2023 apo para njoftimit për kontratë (në ditën e hapjes së tenderëve), Ekspertja shqyrtuese sqaron se vetëm kërkesat si dëshmitë për përfundimin me sukses të kontratave të natyrës të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) dhe qarkullimi financiar/vjetor lidhen me datën e njoftimit për kontratë. Ndërsa marrëveshjet për huazimin e mjeteve të punës, para kontrata apo kontrata me punëtor apo blerje të pajisjeve dhe çdo kërkesë tjetër mund të lidhet deri në orën e fundit të afatit për dorëzimin e tenderit, që do të thotë se në këtë rast, hapja e tenderëve ka qenë me datë 12.09.2023 në ora 14:30h, rrjedhimisht çdo operator ekonomik ka mundur që të lidhë marrëveshje apo kontrata me inxhinier apo staf

tjetër varësisht nga kërkesat e përcaktuar në DT deri me këtë datë 12.09.2023 para orës 14:30h.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me përmbajtjen e kontratës në mes inxhinierit dhe OE të rekomanduar për kontratë, si orari, paga dhe dyshimet e ankuesit se kontrata mund jetë fiktive dhe janë hartuar sa për të përmbushur kërkesën e AK-së dhe ka për qellim ta venë në lajthitje AK-në, etj., Ekspertja shqyrtuese sqaron se ky pretendim ankimor është paragjykues sepse nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje. Sa i përket pikës ankimore që ka të bëjë me kontratën për pagë, orar të punës, ekspertja shqyrtuese konsideron se kontrata e lidhur mes dy palëve është çështje kontraktuale mes palëve dhe nuk mund të kontestoj obligimet kontraktuale të palëve.

Sa i përket pikës tjetër ankimore se inxhinieri Luan Abazi bazuar në listën e të punësuarve nuk është i përfshirë si anëtar i stafit profesional, ekspertja shqyrtuese konsideron se edhe kjo pikë është e pa bazuar sepse kërkesa e AK ka mundësuar që për inxhinier të dëshmohet se kanë kontrata ose para kontratë për këtë projekt e jo ti kenë të punësuar siç pretendon ankuesi. Në kuptim te kësaj dispozite dhe provave te prezantuara, pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Lidhur me pretendim e dytë të operatorit ekonomik ankues, ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës dhe në ofertën e Operatori ekonomik të rekomanduar për kontratë, lidhur me kërkesën nr. 3, i njëjti me tender ka dorëzuar dokumentet si: 8.Makineria Burimi -1.rar 10.marrveshja për Paisje gjeodezike.pdf, 11.Minieskavator,Min 1.5.rar, 12.Marrveshje kamion me kran.rar. Për të dhënë sqarime sa më të qarta lidhur me ketë pretendim, ekspertja shqyrtuese ju ka drejtuar zyrës se prokurim me datë 30.10.23 përmes emalit zyrtar, duke kërkuar që të ofrojnë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë i posedon këto pajisje sipas kërkesë së AK-së. Me datë 31.10.2023 kam pranuar përgjigje lidhur me secilën pajisje të cilën e ka kontestuar ankuesi, në po të njëjtën shkresë është verifikuar se cilat dëshmi ka sjell OE i rekomanduar për kontratë dhe jepen sqarime për secilin mjet. Në bazë të këtij sqarimi të AK-së, ekspertja konsideron se është në kompetencë të autoritetit kontraktues, konkretisht komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit se këto pajisje janë sipas kërkesë së kërkuar pasi të njëjtit në mënyrë të detajuar kanë dhënë sqarime për secilën pajisje të kontestuar. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendim tjetër të ankuesit lidhur se operatorin ekonomik te rekomanduar, ekspertja shqyrtuese sqaron se. OE "NNT Burimi AAF" sh.p.k ka ofruar Marrëveshje për listë të pajisjeve me OE N.N.SH Word Medium mirëpo nuk kemi hasur në pajisje të njëjta siç pretendon OE ankues andaj pretendim është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor, se i njëjti ka marr pjesë në të njëjtën procedurë të, ekspertja shqyrtuese sqaron se kemi kërkuar në faqen zyrtare të ARBK-së për këto dy biznese dhe rezulton se këto dy biznese kanë numër të ndryshëm të numrit unik identifikues dhe kanë pronar të ndryshëm.

Ankuesi në pretendim cek që lista e pajisjeve të dorëzuara nga "NNT Burimi AAF" sh.p.k janë pronë e OE të rekomanduar "Agim Morina" BI me emër tregtar N.N.T. "Burimi", kurse pas shqyrtimit të pajisjeve të OE "NNT Burimi AAF" sh.p.k, rezulton se pothuajse të gjitha pajisjet i ka huazuar nga OE N.N.SH. "Word Medium", ku për më tepër është bashkangjitur lista e pajisjeve me titull "5.Marrveshja për pasije - WORD MEDIUM.rar", ku në këtë dokument janë 52 pajisje të huazuara nga N.N.SH. "Word Medium". Andaj pretendim është i pa bazuar.

Prandaj në mbështetje te asaj qe u përshkrua si më lartë sqarimeve dhe provave të bashkangjitura ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa propozoj që njoftimi i datës 27.09.2023, i AK të mbete në fuqi.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve. Raporti i ekspertit shqyrtues është mjaftë i detajuar i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante qe i referohen aktivitetit

të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve tjera. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve janë të pa bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat duke pasur parasysh edhe rekomandimin e ekspertes shqyrtuese. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Pallaniku në fshatin Berishë KK-Malishevë – Ritender" nr. i prokurimit 62500-23-9341-5-2-1, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka qenë me çmim më të ulët dhe ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe po ashtu të gjitha pretendimet kundrejt ofertës se rekomanduar për kontratë janë të pa bazuara. Andaj duke u bazuar në të gjitha siç u thanë më sipër është vendosur që ankesa të refuzohet si e pa bazuar ndërsa vërtetohet vendimi i AK-B58 i datës 27.09.2023.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103 dhe nenin 117 të LPP për zbatim të procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë të drejtë pa diskriminim me qellim të zgjedhjes së ligjshme dhe efektive të lendes. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP të cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga se u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- OE - **" CAMI KOM " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: